Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 15/17
Date/Datum. 07.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 15/17

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, si dhe nenit 97.1 të Ligjit për Procedurë Administrative Nr. 02/L-28, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "N. T Rahovica & NPSH Bageri"- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari"- Kaçanik 2, 284. 21m"**, me nr. të prokurimit: MI 016/110/511, të shpallur nga autoriteti kontraktues- Ministria e Infrastrukturës (MI), Kryetari i OSHP-së **Z. Blerim Dina**, më datën 07 shkurt 2017, nxori ketë:

V E N D I M

I. **HEDHET,** poshtë si paafatëshme ankesa e OE "N. T Rahovica & NPSH Bageri"- Ferizaj, me nr. të prot. 15/17, e datës 18 janar 2017, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari"- Kaçanik 2, 284. 21m"**, me nr. të prokurimit: MI 016/110/511, të shpallur nga autoriteti kontraktues- Ministria e Infrastrukturës (MI), pasiqë e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor ne AK.

II. **I LEJOHET,** autoritetit kontraktues- Ministria e Infrastrukturës (MI) që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari"- Kaçanik 2, 284. 21m"**, me nr. të prokurimit: MI 016/110/511.

III. Operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

IV. **Obligohet,** OE ankues që konform nenit 36 pika 5 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Operatori ekonomik "N. T Rahovica & NPSH Bageri"- Ferizaj, ka aplikuar si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari"- Kaçanik 2, 284. 21m"**, me nr. të prokurimit: MI 016/110/511, të shpallur nga autoriteti kontraktues- Ministria e Infrastrukturës (MI).

Me datën 23 dhjetor 2016, autoriteti kontraktues, përmes email-it e ka njoftuar operatorin ekonomik me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Operatori ekonomik ankues "N. T Rahovica & NPSH Bageri"- Ferizaj, me datën 23 dhjetor 2016, ka dorëzuar kërkesën për qasje në dokumente në AK-- MI, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari"- Kaçanik 2, 284. 21m"**, me nr. të prokurimit: MI 016/110/511, ndërkaq AK- MI, të njëjtëve iu ka dhënë qasje në dokumentacion me datën 28 dhjetor 2016. OE ankues "N. T Rahovica & NPSH Bageri"- Ferizaj me datën 29 dhjetor 2016, ka bërë ankesë (kërkesë për rishqyrtim) në AK- MI. Me datën 10 janar 2017, autoriteti kontraktues me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Me datën 18 janar 2017, OSHP ka pranuar ankesën e OE ankues "N. T Rahovica & NPSH Bageri"- Ferizaj.

Pas verifikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës Organi Shqyrtues i Prokurimit, konstatoj se kërkesa për rishqyrtim në autoritet kontraktues nga OE ankues është parashtruar jashtë afatit ligjor për faktin se OE ankues është njoftuar me letrën standarde me

datën **23 dhjetor 2016**, ku në po të njëjtën ditë 23 dhjetor 2016 OE ankues ka kërkuar qasje në dokumente. Qasja në dokumentacion i është lejuar operatorit ekonomik me datën 28 dhjetor 2016, në ditën e pestë pas njoftimit me letrën standarde. Kërkesa për rishqyrtim nga OE ankues është parashtruar me datën **29 dhjetor 2016**, duke kaluar kështu afatin **pesë (5) ditor** për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim.

Sipas nenit 4.1 të ***Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave***, kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet te dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

b) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej ***pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.***

Andaj, Kryetari i OSHP-së, duke u bazuar në faktet dhe provat e prezantuara ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim e dorëzuar nga OE ankues në autoritet kontraktues, ka qenë jashtë afatit ligjor, prandaj të njëjtën e hedhë poshtë si të paafatëshme.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij konkluzioni pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesë-padi në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative.

Kryetari i OSHP-së

Z. Blerim Dina

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PRISHTINË TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi i dorëzohet:

1. 1x1 AK- MI
2. 1x1 OE- 1x1 "N. T Rahovica & NPSH Bageri"
3. Arhivës së OSHP-së